



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2023:123741

Datë: 19.03.2024

Numri i dokumentit: 05472619

PPP.nr.854/2021

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, si përmbartimore, me gjyqtari Individual Blerim Istrefi, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit KRM UNITETI me nr të biznesit 70465104 Rr. Vëllezërit Dragaj p/n Mitrovicë, kundër debitorit: L.D.K, Rr. A.H p/n M, për shkak të borxhit në shumë prej 992.44 €, pas prapësimit të ushtruar nga debitori me dt: 29.06.2021, kundër urdhrorit mbi lejimin e përmbartimit P.nr.128/2021 të dt: 07.06.2021, jashtë seance gjyqësore me dt.19.03.2024 nxjerr këtë:

A K T V E N D I M

I.APROVOHET PJESËRISHT prapësimi i debitorit L.D.K, Rr. A.H p/n M, ashtu që **SHFUQIZOHET PJESËRISHT** Urdhri mbi lejimin e Përmbartimit P.nr.128/2021 të dt: 07.06.2021 për periudhën 01.01.2013 e deri me 06.06.2018 në shumë prej 756.04 €.

II.OBLIGOHET debitori L.D.K, Rr. A.H p/n M, që kreditorit KRM UNITETI me nr. të biznesit 70465104 Rr. Vëllezërit Dragaj p/n Mitrovicë, në emër të borxhit për mbeturina për periudhën kohore 07.06.2018 e gjer me 31.05.2021, t'ia paguaje shumën prej 236.40 €, me kamatë ligjore në lartësi prej 8%, duke filluar nga pranimit i këtij vendimi e gjer në pagesën definitive të detyrimit, të gjitha në afat 7 ditore nga pranimit i aktvendimit nën kërcënimin e përmbartimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Kreditori, KRM UNITETI me nr. të biznesit 70465104 Rr. Vëllezërit Dragaj p/n Mitrovicë, ka ushtruar propozim për përmbartim ndaj debitorit L.D.K, Rr. A.H p/n M, duke kërkuar nga përmbartuesi privat të lejoj përmbartimin dhe të obligohet debitori pagesa e borxhit në shumë prej 992.44 € me kamatë ligjore prej 8% si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore, në të kundërtën të bllokoj llogarit bankare të debitorit, e nëse nuk posedon mjete në llogari, sekuestrimin e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme, shitjen e tyre dhe shumën e kërkuar ta transferoi në llogari të kreditorit, të gjitha këto të specifikuar në propozimin për përmbartim të dt. 07.06.2021.

Përmbartuesi Privat, me urdhrin P.nr.128/2021 të dt: 07.06.2021, e ka lejuar përmbartimin sipas propozimit të kreditorit.

Kundër urdhrorit mbi lejimin e përmbartimit debitori, brenda afatit ligjor kanë ushtruar prapësim me shkrim, me propozim që të abrogohet urdhri përmbartimor me arsyetimin se kreditori në rastin e paraqitjes së propozimit për përmbartim duke u bazuar në dokumentin e besueshëm,

përkatësisht me fatura e cila mban obligime te cilat janë parashkruar konform nenit 360 te LMD-së borxhi është parashkruar, ku ky edhe është shkaku i prapësimit sipas LPP-së, nenit 71 par.1.4 kur ka skaduar afati kohor brenda te cilit sipas ligjit mund te kërkohet përmbarimi.

Kreditori KRM UNITETI me nr. të biznesit 70465104 Rr. Vëllezërit Dragaj p/n Mitrovicë ka parashtruar përgjigje në prapësim duke kërkuar qe të refuzohet ne tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit dhe të mbetet në fuqi urdhri përmbarimor pasi që procedura ka filluar ne bazë të faturës e cila i përmban të gjitha elementet e nevojshme konform nenit 40 te LPP-së

Gjykata Themelore Mitrovicë, si përmbarimore në zbatim të dispozitave të nenit 69 e 71 të LPP vlerësoi prapësimin e debitorit dhe gjeti se të njëjtit është i bazuar pjesërisht. Arsyet e paraqitura në prapësimin e debitorit pjesërisht tregojnë shkaqe sikurse në nenin 69 e 71 të Ligjit të Procedurës Përmbarimore, sipas të cilave do të pengohet përmbarimi i lejuar nga përmbaruesi privat.

Gjykata, pas shqyrtimit te prapësimit si dhe pas shqyrtimit te provave tjera ne shkresat e lëndës, konstatoi se lidhur me pretendimet e debitorit lidhur ne atë që të abrogohet urdhri përmbarimor, sa i përket parashkrimit, pretendimet e lartcekura gjykata i aprovoj pjesërisht si te bazuara, mirëpo fillimisht gjykata sqaron faktin në dispozitën në të cilën është thirrur debitori, pra ne nenin 360 te LMD-së rreth parashkrimit, i njëjti nen nuk mund të aplikohet në rastin konkret pasi që kemi raporte në mes dy bizneseve atëherë vjen ne shprehje neni 355 i LMD-së i cili nen flet për kërkesat reciproke nga kontratat komerciale e ku par. 1 parasheh se “Kërkesat reciproke nga kontratat komerciale si dhe kërkesat e shpërblimit të shpenzimeve të bëra lidhur me këto kontrata, parashkruhen për tri (3) vite, andaj i gjithë borxhi i akumuluar për periudhën kohore 01.01.2013 e deri me 06.06.2018 kemi vjetërsim te borxhit sepse nga momenti i ushtrimit te propozimit me dt. 07.06.2021 kanë kaluar ma shumë se tri vite konform nenit 355 par. 1 te LMD-së, andaj gjykata edhe vendosi si ne diapozitiv duke e aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit si ne pikën I te dispozitivit, e njësisht edhe duke e shfuqizuar pjesërisht urdhrin përmbarimor për pjese e parashkruar për periudhën 01.01.2013 e deri me 06.06.2018 në shumë prej 756.04 €.

Kurse sa i përket borxhit për periudhën kohore 07.06.2018 e gjer me 31.05.2021, gjykata gjeti se i njëjti është i bazuar dhe nuk ka vjetërsim-parashkrim të borxhit të kreditorit në raport me debitorin për këtë periudhë kohore, referuar nenin 355 par.1 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (Ligji Nr.04/L-077), në të cilën parashihet që Kërkesat reciproke nga kontratat komerciale si dhe kërkesat e shpërblimit të shpenzimeve të bëra lidhur me këto kontrata, parashkruhen për tri (3) vite, e që në rastin konkret për të gjitha kërkesat e arritura për periudhën kohore 07.06.2018 e gjer me 31.05.2021 nuk kemi kalim të afatit të parashkrimit për këtë periudhë kohore, për faktin se më datë 07.06.2021 kreditori ka ushtruar propozim për përmbarim, me çka ka shkaktuar ndërprerjen e rrjedhjes së afatit të parashkrimit konform nenit 369 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Meqenëse në rastin konkret është vërtetuar se debitori ka mbetur borxh ndaj kreditorit për shumën e cekur në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi, gjykata lidhur me këtë pjesë të kërkesës së kreditorit e refuzoi pjesërisht prapësimin e debitorit dhe e la në fuqi pjesërisht urdhrin për lejimin e përmbarimit P.nr.128/2021 të dt: 07.06.2021, i lejuar nga Përmbaruesit Privat Isa Shala, me seli në Prishtinë, për shumën prej 235.40, pasi që vlerësoi se borxhi për këtë shumë nuk është parashkruar.

Nga arsyet e paraqitura, në bazë të nenit 73 të LPP, kjo gjykatë gjeti se prapësimi i debitorit pranohet pjesërisht, si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Sa i përket kamatës së aplikuar për detyrimin e aprovuar si në pikën **II** të dispozitivit, gjykata i është referuar nenit 382 par.1 dhe 2 të LMD-së.

Gjykata konform nenit 17 të LPP-së, përshtatshmërisht zbaton dispozitat e të LMD-së.

Prandaj nga të lartcekurat, e duke u bazuar në nenin 3,17 29 par.1.2 dhe 1.3, 69 71, 73 par 3 të LPP-së (Ligjit për Procedure Përmbartimore), në lidhje me nenin 355 par.1 dhe 2, 368 par. 1 dhe 382 par.1 dhe 2 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
PPP.nr.854/2021, dt.19.03.2024

GJYQTARI
Blerim Istrefi

UDHËZIM MBI MJETIN JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi, lejohet e drejta në ankese, në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.